

MEDPAK
(Mbrojtja e të Drejtave të Personave
me Aftësi të Kufizuara)



RAPORT DY- VJEÇAR

2014 - 2016




RAPORT DY VJEÇAR

MEDPAK (Mbrotjtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara)

BOTIM I SHOQATËS MEDPAK



Adresa: Rruga "Sh. Ishmi", Pallati 38,
Shkalla 1, Apt. 2, Tiranë
Tel: +355 4 23 45 028
Mobile: +355 69 3577 247 / +355 68 2578 002
E-mail: info@medpak.org
website: www.medpak.org
 @MEDPAK.ALBANIA

Publikimi i këtij materiali mundësohet nga projekti "Arsimi Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Nevoja të Veçata Arsimore në Shqipëri", mbështetur nga Kooperacioni Italian për Zhvillim/ Ministria e Punëve të Jashtme të Italisë dhe zbatuar nga Save the Children dhe MEDPAK.

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton pikëpamjet e organizatës Save the Children.



Save the Children

Rruga: Mihal Popi, Ndërtesa 7,
ish Pallatet 1 Maji, (Vila Lami);
PO Box 8185, Tiranë, Albania
Tel: +355 4 2261840 / 2261929
E-mail: info.albania@savethechildren.org
<https://albania.savethechildren.net>
 Savethechildrenal
 SaveChildrenAlb



MIRËNJOHJE DHE FALENDERIME

Kur prindërit mësojnë se fëmija i tyre ka një aftësi të kufizuar ata fillojnë një udhëtim të mbushur me emocione të forta, zgjedhje të vështira, ndërveprime me specialistë të ndryshëm dhe një nevojë të vazhdueshme për informacion dhe mbështetje. Në këtë kuadër vjen edhe ky raport, i cili i dedikohet së pari personave me aftësi të kufizuara, prindërore dhe anëtarëve të shoqatës MEDPAK që kanë qenë protagonistë të zbatimit të projekteve dhe përmbushjes së objektivave që çojnë përpara misionin e shoqatës sonë: Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara anë e mbanë Shqipërisë.

Të dashur prindër, kjo përvojë të cilën nuk e kemi zgjedhur vetë, na ka bërë të ndryshëm, na ka bërë më të mire. Sepse prej saj, kemi ndërmarrë një udhëtim të paplanifikuar, jemi bërë më të fortë dhe intuitivë për t'u përballur me problemet tona. Sepse njerëzit rriten nga vështirësitë.

Kjo përmbledhje është e dobishme edhe për profesionistët që punojnë me familjet dhe fëmijët e tyre me aftësi të kufizuara, për t'u njohur me përpjekjet

tona për të çuar përpara realizimin e të drejtave të PAK dhe ngritjen e kapaciteteve të prindërore e specialistëve, që punojnë me dhe për PAK.


Ia kushtojmë këtë raport gjithashtu të gjithë mbështetësve financiarë dhe shpirtërorë pa të cilët idetë dhe mendimet tona nuk do të mund t'i zbatonim dhe bënim realitet për t'iu ardhur në ndihmë grupit për të cilin ne punojmë.

I shprehim mirënjohjen tonë të gjithë partnerëve, bashkëpunëtorëve, institucioneve publike dhe organizatave të tjera që punojnë për të përmirësuar jetesën e PAK dhe familjeve të tyre duke bashkërenduar punën, idetë, përpjekjet dhe kontributin e të gjithëve që kanë vullnetin të zbatojnë kuadrin ligjor e të lehtësojnë përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri.

**Kryetare e shoqatës
Zela Koka**

MISIONI:

Mbrojmë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara përmes njohjes e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore, trajnimit të anëtarëve e më gjerë, sensibilizimit të komunitetit për rritjen e kërkesave për zbatimin e ligjeve, krijimin e shërbimeve, me qëllim që të arrihet një jetë dinjitoze për të gjithë.



VIZIONI: TË BARABARTË NË TË DREJTA ,TË NDRYSHËM NË NEVOJA

Parimet ku bazohet puna jonë:

- **Mosdiskriminimi**, me anë të cilit garantohej se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë;
- **Barazia**, duke përfshirë edhe barazinë gjinore;
- **Autonomia** e personave me aftësi të kufizuara dhe respektimi i pavarësisë së vendimmarrjes së tyre;
- **Garantimi i aksesueshmërisë** nëpërmjet mënjanimin të pengesave të të gjitha llojeve;
- **Përfshirja**, nëpërmjet së cilës mundësohet pjesëmarrja e duhur dhe e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës;
- **Pjesëmarrja** e personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet konsultimit individual dhe përfshirjes aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre përfaqësuese, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara.

Aspiratat tona/Plani strategjik

- Përfshirje më e madhe e personave me aftësi të kufizuara për çdo planifikim dhe propozim për përmirësim të jetës së tyre dhe realizimin e të drejtave;
- Lobim dhe advokaci për përmirësim të legjislacionit, përmbushjen e të drejtave për arsimim, punësimin, kualifikim dhe shërbime të tjera cilësore për PAK dhe familjet e tyre;
- Promovim i jetesës së pavarur të PAK në komunitetin e tyre.



Projekti “Edukimi Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore në Shqipëri”

Për të tetin vit shoqata MEDPAK në partneritet me Save the Children dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, ka zbatuar projekte me fokus arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Projekti në zbatim “**Edukimi Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore në Shqipëri**” shtrihet në periudhën tre vjecare (Korrik 2014- Qershor 2017) dhe synon krijimin e aksesit dhe arsimimin në shkolla gjithëpërfshirëse të fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe vështirësi në të nxënë në shtatë rajone të Shqipërisë: Gjirokastrë; Korçë; Elbasan; Durrës; Burrel; Peshkopi dhe Vlorë. Ky projekt financohet nga Agjensia e Kooperacionit Italian i të Zhvillimit/Ministria e Jashtme Italiane dhe zbatohet nga Save the Children në partneritet me shoqatën Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara (MEDPAK),



dhe Drejtoritë Arsimore Rajonale (DAR) në Korçë, Elbasan, Durrës, Burrel, Peshkopi, Gjirokastrë dhe Vlorë, si edhe njësitë e qeverisjes vendore në këto rajone.

Projekti “Arsim Gjithëpërfshirës” ishte një nismë ambicioze, vizionare e bazuar në përjasjen e vlerësimit të aftësisë së kufizuar si një çështje e të drejtave të njeriut/ fëmijëve dhe me synim të qartë të realizimit të një procesi reformues të politikave, kulturave dhe praktikave ekzistuese. Përballja me realitetin e arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, vlerësimi i shkollave speciale si alternativa më e mirë e arsimimit të tyre, kultura mbizotëruese e mospranimit të këtyre fëmijëve në kopshte e shkolla etj, ishin paralajmëruese të një pune sfiduese.



Ky projekt mbështetet në Objektivat strategjikë të MASH dhe qeverisë shqiptare për krijimin e një shkolle cilësore me synim krijimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse. Komuniteti shkollor nxënës, mësues dhe prindër po përfitojnë nga lehtësimi i punës për krijimi i shkollave dhe kopshteve gjithëpërfshirëse. Stafet e DAR-ve në: Gjirokastrë, Korçë, Vlorë, Burrel, Durrës, Peshkopi dhe Elbasan do të rrisin kapacitetet e tyre në lidhje me ngritjen dhe funksionimin e Komisioneve multi-disiplinore, për vlerësimin e nevojave arsimore të nxënësve.

Aktivitetet kryesore të këtij projekti ja në:

- Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, në klasa dhe grupe bashkë me moshatarët e tyre bazuar në PEI të ndërtuar për secilin prej tyre.
- Ngritja e komisioneve multi-disiplinore në DAR/ZA, fuqizimi i tyre nëpërmjet trajnimeve formale dhe jo formale.
- Organizimi dhe zhvillimi i kurseve të trajnimit me punonjës të arsimit për zbatimin e praktikave gjithëpërfshirëse.
- Organizimi dhe zhvillimi i kurseve të trajnimit me punonjës të shërbimit psiko-social si pjesë e rëndësishme e komisionit.



- Takime formale dhe jo formale me prindër për të bërë edhe ata pjesë aktive të punës në shkollë dhe kopsht.
- Shkëmbim eksperiencash midis prindërve, mësuesve që punojnë direkt me fëmijë me aftësi të kufizuar në klasa gjithëpërfshirëse me kolegë të tyre në rajonet ku është zbatuar më parë ky projekt.
- Ngritja e mjediseve burimore, nga një në çdo rajon, për të lehtësuar arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar .
- Pajisja e shkollave me bazë materiale didaktike për tu mbështetur edukimin e fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.
- Ndërhyrje infrastrukturore në objektet e disa shkollave në mënyrë që ato të bëhen më të aksesueshme për fëmijët me nevoja të veçanta.
- Dokumentimi i të dhënave statistikore në mënyrë periodike, për të vlerësuar arritjet dhe nevojat e fëmijëve në vite



Arritjet kryesore gjatë zbatimit të këtij projekti

1. Një nga përparësitë e projektit ishte ngritja e kapaciteteve të mësuesve duke ofruar trajnime me module të akredituara në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës dhe të Korçës. Mësuesit janë aktorët që përbëjnë hallkën më të rëndësishme në zbatimin e procesit gjithëpërfshirës. Suksesi i nxënësve lidhet pashmangshmërisht me përgjegjshmërinë e tyre, nivelin e njohurive dhe aftësive në mësimdhënie si dhe efektivitetin e zbatimit të ligjit. Trajnimet me mësuesit kanë pasur në fokus zhvillimet e fundit mbi çështje që lidhen me aftësinë e kufizuar, karakteristikat e çrregullimeve dhe aftësive të kufizuara si dhe mënyrat dhe përjasjet për të mbështetur dhe lehtësuar arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta arsimore në shkolla gjithëpërfshirëse;



Modulët e trajnimeve të përdorura me specialistë që punojnë direkt me fëmijët me aftësi të kufizuara apo vështirësi në të nxënë, janë të pasqyruara përmblendhtazi më poshtë në baze të tematikave të trajnimit.

- ✓ Trajnim me specialistët e komisionit të DAR për Klasifikimin Ndërkombëtar të funksioneve për fëmijët dhe të rinjtë.

Specialistë të komisioneve me bazë në Drejtoritë Arsimore u trajnuan në tre sesione për Klasifikimin Ndërkombëtar të funksioneve të fëmijëve dhe të rinjve (ICF-CY), me qëllim realizimin e vlerësimeve sa më profesionale bazuar në instrumenta që përdoren në nivel ndërkombëtar.

- ✓ Përfshirja e nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin e zakonshëm në Shqipëri.

Modul trajnimi i përshtatur për punonjësit e arsimit, i fokusuar tek llojet e aftësive të kufizuara dhe vështirësive në të nxënë dhe karakteristika të sjelljeve të këtyre fëmijëve. Materiali vijon me informacione për mësuesit për evidentimin e nevojave dhe burimeve të mbështetjes për një shkollë gjithëpërfshirëse, roli i mjedisit social dhe efekti i tij tek të nxënëit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, probleme të zhvillimit të fëmijëve dhe i orienton ata lidhur me bashkëpunimin me specialistët e tjerë dhe prindërit e tjerë për të mundësuar një edukim cilësor dhe një klimë pozitive të nxëni.

✓ Të kuptojmë dhe menaxhojmë sjelljet e fëmijëve me autizëm në klasa gjithëpërfshirëse:

Trajnimi u përqëndrua tek njohja me autizmin, karakteristikat e tij, vështirësitë me të cilat hasen mësuesit në menaxhimin e sjelljeve të fëmijëve me autizëm në klasë. Mësuesit u informuan për përdorim i teknikave të përforsimit pozitiv si mjet për motivimin e nxënësve me autizëm, dhe aspekte të tjera të punës së individualizuar dhe mënyrave për përfshirjen e tyre efektive në klasë.

2. Trajnime me prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara

Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara janë aktorët kryesorë të gjithëpërfshirjes. Ata ndeshen me vështirësi e pengesa serioze gjatë rritjes dhe edukimit të fëmijëve të tyre. Mungesa e njohurive të mjaftueshme rreth karakteristikave të zhvillimit të fëmijëve, mënyrave se si duhet të përballojnë emocionet e si duhet të mbështesin proceset gjithëpërfshirëse nxori në pah dukshëm nevojën e trajnimeve të prindërve. Trajnimet me prindër kanë pasur në fokus adresimin e të gjitha nevojave dhe vështirësive të tyre për të edukuar fëmijët dhe shtuar informacionin se si duhet të punojnë me fëmijët e tyre dhe si mund të ndihmojnë në realizimin e proceseve gjithëpërfshirëse në kopshte, shkolla e shoqëri.

✓ Njohja me legjislacionin dhe të drejtat prindërore për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara;

Moduli i këtij trajnimi rriti kapacitetet e mësuesve dhe specialistëve të tjerë në lidhje me elementët strukturore të PEI, arsyet se pse është i domosdoshëm, si hartohet, çfarë duhet të përmbajë ky dokument dhe se si mund të sigurohet zbatimi efikas i këtij plani. Materiali ofron modele të ndryshme planesh edukative individuale dhe shembuj konkretë planesh të plotësuar të fëmijëve me aftësi të kufizuara.



✓ **Çfarë duhet të dimë lidhur me procesin e rritjes dhe edukimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë;**

Ky modul synon të rrisë nivelin e njohurive dhe aftësive të prindërve lidhur me dilemat e rritjes dhe socializimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë. Përmes informacionit të këtij manuali, prindërit ndërgjegjësohen të praktikojnë teknika të përshtatshme për të nxitur dhe zhvilluar aftësitë dhe shprehitë e pavarësisë e autonomisë së fëmijëve dhe të kuptojnë rëndësinë e krijimit të një mjedisi të përshtatshëm, që ndihmon dhe stimulon një zhvillim të mirë mendor, social e emocional të fëmijëve.



✓ **Mësimdhënia për nxënësit me vështirësi në të nxënë:**

Ky modul përfshin informacion të plotë në lidhje me llojet e vështirësive në të nxënë që ndeshen më shpesh tek fëmijët e moshës shkollore, karakteristikat e tyre, vështirësitë me të cilat hasen këta fëmijë në procesin e mësimin dhe mënyrave se si mësuesit duhet të ndërtojnë punën në varësi të llojeve të vështirësive në të nxënë.



✓ **Lobimi dhe advokacia**

Lobimi dhe advkacia, është një tjetër modul i përgatitur për prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara si një grup i rëndësishëm interesi që mund të influencojnë politikat sociale për të arritur objektiva të interesit kolektiv. Prindërit janë aftësuar të evidentojnë strategji efikase advokuese e lobuese për të modeluar perceptimin publik mbi çështjet të aftësisë së kufizuara, apo ndër vepruar me autoritetet

3. Realizimi i aktiviteteve sensibilizuese edhe advokuese të zhvilluara në kuadrin e projektit dhe me mbështetjen e tij kanë qenë të shumta e të llojeve të ndryshme. Qeveritë e nxënësve, si struktura të rëndësishme të ndryshimeve dhe të vendimmarrjes në shkollë, kanë qenë iniciatorë dhe partnerë të aktiviteteve advokuese në shkolla. Aktivitete advokuese për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara janë zhvilluar edhe në nivel organizimesh të rëndësishme në qytete. Me rasatin e ditëve ndërkombëtare janë shpërndarë tek qytetarët fletëpalosje dhe materiale informuese për prindër dhe mësues, të cilat përcjellin mesazhe respekti ndaj të drejtave të fëmijëve si të kufizuara pa asnjë dallim, duke i vlerësuar ata si qenie me të drejta të plota për arsim, argëtim, kujdes të veçantë, trajtim në përputhje me mundësitë dhe aftësitë e tyre etj.



4. Një element tjetër i këtij projekti në kuadrin e krijimit të kushteve të favorshme për të lehtësuar arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara ishte edhe **pajisja me bazë materiale e një mjedisi brenda shkollës**. Pajisja me bazë materiale didaktike për kopshtet është zgjidhur dhe adresuar më mirë në raport me kërkesat që ka shkolla për mjete didaktike, veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara.



5. Janë kryer ndërhyrje infrastrukture në vitet e mëparshme të projektit ndërsa për projektin në zbatim janë kryer vlerësimet ndërtimore të institucioneve arsimore të përfshira në këtë projekt me qëllim ndërhyrjen në infrastrukturën e shkollës për të kryer adaptimet e nevojshme për të siguruar akses për arsimim të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për këto ndërhyrje.

Zbatimi i projektit arsim gjithëpërfshirës, synoi të adresonte disa nga problemet me të cilat ndeshet arsimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe të krijojë një model i cili duhet të replikohet dhe përmirësohet më tej për të përmbushur standardet e nevojshme të gjithëpërfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në edukim dhe shoqëri.



Projekti “Fuqizimi i kapacitetit të shoqërisë civile për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Shqipëri”

Ky projekt zbatohet në partneritet me shoqatën Partnerë për Fëmijë dhe World Vision Britani e Madhe me fonde të Bashkimit Evropian në rajonet: Elbasan, Dibër, Tropojë, Kukës, Lezhë, Tiranë, Vlorë, Korçë dhe Shkodër.



Qëllimi kryesor i këtij projekti është:

Të lehtësojë zbatimin e legjislacionit për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara për arsimim dhe mbrojtje, të fuqizojë shoqërinë civile për të marrë pjesë efektivisht në hartimin e politikave në bazë rajoni për gjithëpërfshirjen e fëmijëve e fëmijëve me aftësi të kufizuara;

Objektivat e projektit janë:

1) Të kontribuojë në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, duke u fokusuar në përmbushjen e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

2) Të rrisë kapacitetet e shoqërisë civile dhe strukturave jo-qeveritare për të ofruar shërbime cilësore për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe për të gjeneruar iniciativa bazuar në nevojat e tyre.

Përfitues në këtë projekt janë 200 fëmijë me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë të moshës 3-16 vjeç nga 10 shkolla në Elbasan dhe Dibër, grupet e të rinjve/qeveria e nxënësve, organizatat e shoqërisë civile për personat me aftësi të kufizuara, prindërit dhe familjet, bordet e shkollave, mësuesit, psikologët e shkollave (nga 10 shkolla), 50 profesionistë nga 9 rajone (mësues, staf shëndetësor, punonjës social, punonjësit e Zyrës për Mbrojtjen e Fëmijëve, psikologët), përfaqësuesit e pushtetit lokal (Elbasan dhe Dibër), 21 organizata të shoqërisë civile (pjesë e Koalicionit Shqiptar Aftësia e Kufizuar dhe Zhvillimi (KSHAKZH), organizata që punojnë për dhe me personat me Aftësi të Kufizuara.





Aktivitetet kryesore të projektit

1. U bë vlerësimi i situatës për të matur praktikatat ekzistuese në Dibër dhe Elbasan për zbatimin e Ligjit Parauniversitar për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe bazuar në gjetjet, do të organizohen:
 - a- konsultime me profesionistë, anëtarë të komunitetit dhe fëmijët me aftësi të kufizuara për të diskutuar rekomandimet;
 - b- Takime konsultative me përfaqësuesit e pushtetit lokal për të mbështetur zbatimin e ligjit ekzistues për Arsimin Parauniversitar dhe për të promovuar arsim gjithëpërfshirës bazuar në të dhënat e rekomandimeve;

2. Studentë të mësuesisë dhe punës sociale në bashkëpunim me drejtoritë e shkollave ofruan internship në shkollat e përfshira në projekt.
3. U organizuan sesione informuese për Ligjin nr. 69/12 të Arsimit Parauniversitar dhe trajnime të mësuesve bazuar në manualin “Jam mes Jush”.
4. Janë organizuar tryeza të rrumbullakëta për profesionistët nga 9 rajone për të shkëmbyer përvojat për arsimin gjithëpërfshirës në bashkëpunim me OJF për prindër dhe fëmijët me aftësi të kufizuara.
5. Janë organizuar trajnime me prindër dhe trajnime me mësues në vendin e punës.
6. Aktivitete me qeverinë e nxënësve, bordet e shkollave, këshillat e prindërve.



Rezultate qe u arritën në këtë projekt janë:

- Nga advokimi dhe lobimi janë krijuar praktika më të mira në zbatimin e Ligjit Arsimor Para-Universitar në Rrethine Dibrës dhe Elbasanit.
- Organizata të shoqërisë civile kanë përmirësuar aftësitë e tyre në menaxhimin e projekteve që kanë të bëjnë me zbatimin e të drejtave të fëmijëve më aftësi të kufizuara dhe është krijuar një rrjet i organizatave që punojnë në rajonet Elbasan dhe Dibër.
- Janë rritur kapacitetet e ekipeve multi-disiplinore

në 9 rajone për të vlerësuar nevojat arsimore për çdo fëmijë me aftësi të kufizuara.

- Komisionet e 9 rajoneve hartuan një draft rregullore të funksionimit të komisionit të vlerësimit në DAR për fëmijët me nevoja speciale në arsim.
- Fëmijë, prindër, organizata dhe anëtarë të komunitetit shkollor janë ndërgjegjësuar dhe kanë rritur njohuritë e tyre rreth arsimit gjithëpërfshirës nëpërmjet programeve me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara në këto dy rajone Dibër dhe Elbasan.



Qendra Burimore për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara në Koplik

Qendra Burimore për fëmijë me Aftësi të Kufizuara në Koplik është ngritur nga një bashkëpunim i bashkisë Malësi e Madhe me shoqatën MEDPAK me mbështetje të shoqatës Child's Perspective në Hollandë.

Qëllimi i hapjes së kësaj Qendre ka qenë: Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara me qëllim krijimin e një jete dinjitoze për gjithë personat me aftësi të kufizuar.

Objektiva specifike:

1. Të ofrohen shërbime ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara dhe të informohen prindërit e tyre për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.
2. Fëmijët me aftësi të kufizuar të arsimohen në shkollë me bashkëmoshatarë të tyre dhe të rriturit me aftësi të kufizuar të aftësohen për t'u punësuar bazuar në aftësitë që ata kanë.
3. Të ndërgjegjësohet komuniteti për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar dhe të punohet për krijimin e një komuniteti gjithëpërfshirës.

Puna me fëmijët dhe takimet me prindërit kanë vazhduar normalisht. Qendra është e hapur çdo ditë dhe fëmijët vazhdojnë ta frekuentojnë e janë shumë të kënaqur. Prindërit shprehen se fëmijët e tyre presin me padurim

të vijnë në qendër. Programi që ndiqet në punën me fëmijët bazohet tek aftësitë që ka secili prej tyre.

Takimet me prindërit janë të përditshme ku diskutojmë për atë çfarë është bërë në qendër me fëmijën, në mënyrë që të koordinojmë punën për të pasur një rezultat të kënaqshëm. Prindërit takohen rregullisht me njëri-tjetrin në qendër dhe ndajnë më njëri-tjetrin eksperiencat e tyre, kalojnë kohën e lirë me fëmijët dhe ofrojnë ndihmën e tyre vullnetare për mirëmbajtjen e qendrës. Përmes trajnimeve ata kanë zhvilluar aftësitë e tyre për të punuar me fëmijët.

Suksesi dhe vazhdimësia e funksionimit të këtij shërbimi kushtëzohen nga bashkëpunimi me bashkinë e Malësisë së Madhe.

Në 2 Prill, në Ditën Ndërkombëtare Të Ndërgjegjësimit Për Autizmin u organizua një aktivitet sensibilizues për pranimin e këtyre fëmijëve dhe gjithëpërfshirjen e



tyre në jetën sociale. Ky aktivitet u realizua në qendër të qytetit të Koplikut dhe shumë kalimtarë patën mundësinë që të merrnin një mesazh shumë të qartë: *Pranoni këta fëmijë! Është një detyrë e përbashkët! Ndihmoni ata të rriten! Ata janë një potencial, por me një mënyrë të shprehuri ndryshe!*

Nxënësit e shkollës 9-vjecare 'Abdyl Bajraktari' dhe të gjimnazit "Sherif Hoxha" të shoqëruar nga psikologët e shkollave erdhën pranë qendrës MEDPAK të gjithë

të veshur me bluza të bardha me një shirit blu në të, po ashtu disa prej tyre mbanin në dorë një pankartë të madhe ku shkruhej: "Autizmi, zëri i heshtur që duhet të mësojmë ta dëgjojmë". Nisja e aktivitetit konsistoi në një ecje të përbashkët nga qendra deri në fund të qytetit ku secili prej nxënësve mbante në dorë tullumbace ngjyrë blu e cila është ngjyra që simbolizon Autizmin. Në përfundim të gjithë në një kohë lëshuam tullumbacet në shenjë solidarizimi.

IV. Qendra Burimore në mbrojtje të drejtave të personave me aftësi të kufizuara Librazhd.

Kjo qendër funksionon prej viti 2002. Qendra tani shërben më shumë si qendër informimi dhe trajnimi për gjithë komunitetin e Librazhdit, mësuesit, prindërit, prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe vetë bashkëmoshatarët e tyre.

Ne vitin 2015 filloi një bashkëpunim i ri me bashkinë Librazhd për kthimin e Qendrës ditore në një Qendër që tu shërbejë jo vetëm fëmijëve me aftësi të kufizuar por gjithë komunitetit të personave me aftësi të kufizuar dhe familjarëve të tyre. Synimi i shoqatës MEDPAK për këtë qendër është që të punohet me personat me aftësi të kufizuar për ti trajnuar ata për një jetës së pavarur. Në këtë Qendër gjendet edhe një bibliotekë e pasur për arsimin gjithëpërfshirës dhe për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.



V. Përfshirja e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara në Kampe Verore

Titulli i Projektit: Vijnë së Bashku

Shoqata zbatuese: MEDPAK

Organizata partnere: World Vision Albania

Qëllimi: Të promovojmë nëpërmjet lojës dhe argëtimit gjithëpërfshirjen sociale, duke pranuar diversitetin dhe duke i ofruar të gjithë fëmijëve mundësi të barabarta.

Objektivat:

- ▲ Të nxisim dhe inkurajojmë fëmijët për të bashkëpunuar dhe bashkëvepruar me njëri-tjetrin duke pranuar diversitetin.
- ▲ Të rrisin pjesëmarrjen aktive dhe sociale të fëmijëve nga grupet vulnerabël nëpërmjet lojës dhe argëtimit. I gjithë organizimi i kampit kishte si qëllim dhe objektiv kryesor aktivizimin dhe gjithëpërfshirjen e fëmijëve pa dallim aftësie race dhe besimi.
- ▲ Të përmirësoheshin aftësitë e specialistëve nëpërmjet të punuarit praktik. Mësuesit punonjës social ishin pjesë e lehtësimit të punës dhe aktiviteve në skuadër.
Pjesëmarrës: Përfituesit e kampit veror ishin 44 fëmijë nga grupet vulnerabël të grupmoshës 8 - 15 vjec.

Metodologjia:

Metodologjia që u ndoq në aktivitetet e kampit ishte interaktive dhe e fokusuar drejt aktiviteve edukuese, sociale, krijuese, ndërgjegjësuere. Aktivitetet ishin të natyrave të ndryshme.

Kampi veror përmirësoi aftësitë sociale, vetë-besimin dhe respektin për njëri-tjetrin duke zënë miqësi të reja, duke zhvilluar aktivitetet të ndryshme, duke fituar pavarësinë dhe duke u dhënë të gjithë fëmijëve mundësinë e lidërshiptit.



VI. Projekti “Të rinjtë me aftësi të kufizuara intelektuale: Vet Advokues”

Ky projekt ka qenë i përqëndruar në arritjen e qëllimit për të forcuar, të rinjtë me aftësi të kufizuara intelektuale për vet-përfaqësim dhe vet-advokaci. Fokusi i projektit ka qenë të trajnojë të rinjtë e grupit vet-advokues me aftësi të kufizuara intelektuale/mendore për të marrë pjesë aktive në aktivitetet advokuese si dhe të rris ndërgjegjësimin e komunitetit për të drejtat e personave me AK intelektuale nëpërmjet fushatës në media. Aktualisht projekti ka përgatitur një grup vet-advokuesish prej 20 të rinjsh me AK intelektuale.

Objektivat e realizuara

Objektivi 1:

Të forcojë të rinjtë me aftësi të kufizuara intelektuale/mendore për vet-përfaqësim dhe vet-advokaci.

Rreth 70 prindër, të rinj me aftësi të kufizuara intelektuale dhe disa anëtare nga OJQ të ndryshme kanë qenë pjesëmarrës aktivë në workshopet e realizuara në 3 qytetet Tiranë, Librazhd dhe Shkodër. Këto workshopet kishin si qëllim t’u ofronin prindërve dhe përfaqësuesve nga OJQ informacion për projektin si edhe të sensibilizonin ata për të drejtat e fëmijëve të tyre për vet-përfaqësim si dhe të kuptonin rëndësinë që fëmijët e tyre me aftësi të kufizuara MUND dhe DUHET të vetë përfaqësohen. Njohuritë e marra nga trajnimi dhe workshopet e organizuara me prindërit dhe përfaqësuesit e OJQ u përcaktua



dhe grupin prej 20 të rinjsh me AK intelektuale që do të ishin grupi kryesor i projektit. Të rinjtë gjatë implementimit të projektit u trajnuan për ngritjen e njohurive në fushën e të drejtave, të advokacisë, të mënyrës së komunikimit etj. Ekspertë nga organizata ceke PIN mbështeten për ngritjen e kapaciteteve të 15 anëtareve të stafit të 2 organizatave që zbatuan projektin si dhe 26 të rinjve me aftësi të kufizuara intelektuale. Temat e trajtuara ishin: “Themelimi i grupeve vetë advokuese për dhe nga personat me aftësi të kufizuara intelektuale në Shqipëri” dhe “Roli i grupeve vetë advokuese për dhe nga personat me aftësi të kufizuara intelektuale”. Përgjatë realizimit të trajnimeve pjesëmarrësit arritën:

- Të rrisin njohuritë në lidhje me të drejtat e qytetarëve me aftësi të kufizuara intelektuale

dhe nevojën për përmirësimin e politikave, dhe ligjeve që kanë të bëjnë me qytetarët me aftësi të kufizuara intelektuale;

- Të identifikojnë format për tejkalimin e vështirësive potenciale përgjatë procesit të themelimit të grupeve vetë-advokuese.

Grupi u trajnua për rolin e personave përkrahës të grupeve vetë advokuese përgjatë mbajtjes së takimeve të rregullta, identifikimit të anëtarëve të rinj, rrjetëzimit në mes të grupeve dhe përfaqësimit të interesave të grupeve tek institucionet e shtetit, organizatat jo qeveritare apo komuniteti. Në trajnim u diskutuan me pjesëmarrësit dhe modele të suksesshme me grupe të ngjashme në Kosovë dhe nëpër vende të tjera. Gjithashtu këto aktivitete të organizuara kanë ç'mitizuar nocionin e "paaftësi mendore" dhe kanë dëshmuar në shoqëri se ata mundën. Nga takimet e organizuara vetë të rinjtë kanë ideuar dhe fushatën ndërgjegjësuese të organizuar me rastin e 3 Dhjetorit ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara.



Objektivi II:

Rritja e ndërgjegjësimit për të drejtat e personave me AK intelektuale nëpërmjet fushatës në media.

Në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit për të drejtat e personave me AK intelektuale gjatë zbatimit të projektit janë realizuar takime informale dhe formale me komunitetin dhe prindërit e vetë të rinjve me AK. Këto takime kanë pasur si qëllim krijimin e urave të bashkëpunimit për pjesëmarrjen aktive të të rinjve në këtë projekt si dhe ndërgjegjësimin e shoqërisë për pozicionin e personave me AK intelektuale, vet-përfaqësimin e tyre. Në emër të grupit të Advokimit të Personave me AK intelektual edhe në emër të 2 shoqatave që kanë zbatuar këtë projekt i janë dërguar letra informimi institucioneve të ndryshme publike. Një grup përfaqësuesish nga të rinjtë me AK intelektuale kanë qenë pjesë e Seancës dëgjimore publike të Komisionit Parlamentar të Shërbimeve Sociale Punësimit dhe Shëndetësisë. Ata kanë përcjellë në këtë seancë zërin e gjithë të rinjve me aftësi të kufizuara intelektuale në mbrojtje të drejtave të kësaj kategorie. Në kuadër të 3 dhjetorit të rinjtë kanë arritur të ideojnë dhe të realizojnë vetë një spot publicitar me moton "UNË MUNDEM" dhe kanë marrë pjesë në emisionet sociale në media. Si rezultat i aktiviteteve të zhvilluara gjatë këtyre muajve është arritur që të rinjtë:

- A. Të jenë aktiv në takimet e organizuara
- B. Të krijojnë vet vlerësim dhe vet besim
- C. Të njihen dhe të socializohen me njëri tjetrin
- D. Të fillojnë të konsolidohen si grup
- E. Të jenë shembull ideal për promovimin e jetesës së pavarur për personat me aftësi të kufizuara intelektuale në vend gjithashtu.

VII . Projekti punësimi i grave, një mundësi për integrim “ Potencialit i jepet mundësia”

Ky projekt u zbatua gjatë vitit 2014 në zonën e Librazhdit. Ai synoi fuqizimin ekonomik të grave përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës dhe respektimin e barazisë gjinore. Përmes këtij projekti është stimuluar biznesi për të krijuar vende të reja pune duke u mundësuar grave nga grupet vulnerabël (egjiptianë, të divorcuar, nënat e reja me fëmijë me aftësi të kufizuara), të fitojnë një pagë për të mbështetur veten dhe familjet e tyre. Këto gra jo vetëm që po ndihmojnë financiarisht familjet e tyre, por për herë të parë ata ndërgjegjësojnë komunitetin të reduktojë paragjykimet dhe stigmatizimin ndaj tyre. Gjatë zbatimit, projekti u përqendrua në arritjen e qëllimit: “Komunitetet dhe familjet duhet të ndërgjegjësohen për barazinë gjinore, në garantimin e të drejtës për punësim”

Objektivat kryesore të projektit ishin:

1. Rritja e ndërgjegjësimit të familjeve për barazinë gjinore dhe
2. Ndërmjetësimi midis institucioneve shtetërore dhe bizneseve për punësimin e grave.

U konstatua gjatë takimeve të realizuara, një mungesë bashkëpunimi midis Zyrës së Ndihmës Ekonomike, Zyrës së Punës dhe të Bizneseve. MEDPAK organizoi

dhe lehtësoi një set takimesh që synuan të nxisnin bashkëpunimin dhe ndarjen e informacionit midis institucioneve shtetërore dhe sferës së biznesit. Për këtë u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi dhe mbështetje në realizimin e këtij projekti. Gratë e përzgjedhura nga listat e institucioneve respektive u nxitën të punonin në fabrikën e riciklimit. Për shkak të vështirësive financiare të fabrikës, u organizuan takime me biznese të tjera dhe u nënshkrua një marrëveshje me një biznes fasonerie të sapo inauguruar. Kështu, 9 gra u punësuan në fabrikën e riciklimit, 16 në fasoneri dhe 1 në një shërbim bar-



restoranti (gjithsej 26 gra). “Është një hap pozitiv- u shpreh Znj. Manushaqe Hoxha, specialiste e Zyrës së Punës, kështu mund të realizojmë objektivin tonë për të punësuar gratë dhe përfshirë ato në jetën sociale”. Znj. Drita Rresha, tregoi entuziazmin e saj për mundësinë e të qenit përfituese e këtij projekti, për të kontribuar më shumë në familje dhe për t’u ndjerë e barabartë. Një sërë trajnimesh u zhvilluan për të drejtat e grave dhe veçanërisht burrat dhe djemtë u informuan për rëndësinë e grave në familje dhe punë.

Aktivitetet kryesore të projektit

- Nënshkrimi i marrëveshjeve me bashkëpunëtorët e partnerët që ndihmuan në realizimin e qëllimit dhe objektivave të projektit;

- Identifikimi i grave nga grupet e marginalizuara, që ishin përfituese të projektit;
- Vlerësimi i situatës familjare, sociale dhe ekonomike të grave
- Organizimi i trajnimeve me tematika të ndryshme sociale rreth të drejtave të grave e barazisë gjinore;
- Realizimi i tryezave të rrumbullakëta me pjesëmarrjen e autoriteteve lokale, biznesit të zonës, OJQ dhe gratë përfituese;
- Regjistrimi në zyrën e punës dhe shkrimi i kontratave të punësimit për gratë përfituese;
- Trajnime në vendin e punës për njohjen dhe përvetësimin e teknikave të riciklimit;
- Takime me komunitetin për të promovuar punësimin e grave.



VIII. Fuqizimi i degëve të shoqatës MEDPAK në rajone të ndryshme të Shqipërisë



Shoqata MEDPAK, funksionon mbi bazën e degëve të saj në 9 rajone të vendit, për t'u ardhur në ndihmë prindërve sa më afër vendbanimit të tyre. Funksionimi mbi baza vullnetare dhe me fonde të përfituara nga dashamirës e disa biznese, sjell probleme në realizimin në mënyrë konstante të aktiviteteve që ndërmerren në këto rajone.

Me gjithë punën e tyre advokuese dhe lobimin në institucionet shtetërore, shpesh prindërit përballen me premtime që nuk realizohen kurrë dhe kjo i demoralizon dhe lëkund besimin e tyre. Një nga degët më aktive të prindërve është ajo e Korcës, ku prindërit kanë qenë bashkë për të ngritur zërin e tyre për realizimin e të drejtave të fëmijëve. Një nga aktivitetet më të rëndësishme ishte ai i organizuar në kuadrin e Ditës Ndërkombëtare të Ndërgjegjësimit për Autizmin në teatrin e qytetit "A.Z.Cajupi" që përcolli mesazhe të fuqishme dhe bashkoi zërat

e prindërve për të kërkuar më shumë të drejta të realizuara dhe shërbime për fëmijët e tyre me autizëm.

Në ditën e 3 Dhjetorit u zhvilluan disa veprimtari. Në bashkëpunim me Universitetin e Korcës prindërit zhvilluan një veprimtari të titulluar "Fjalën e kanë prindërit", me pjesëmarrjen e studentëve, pedagogëve, mësuesve e punonjësve të shërbimit psiko-social të shkollave ku u rrahën mendimet në lidhje me nevojat dhe mundësitë për të siguruar një arsim sa më cilësor për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në bashkëpunim me Shkollën Speciale, Qendrën e Formimit Profesional dhe prindër rreth 50 pjesëmarrës, në datë 10 dhjetor, Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut u zhvillua një tjetër veprimtari për të koordinuar përpjekjet e të tre palëve, prindërve, profesionistëve dhe institucioneve, për t'u ofruar fëmijëve mundësi më të mira arsimimi dhe edukimi.

Fjalë frymëzuese për prindërit!

Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk shohin aftësinë e kufizuar tek fëmijët e tyre. Ata shohin bekimin më të çmuar dhe të mrekullueshëm të jetës së tyre, ata shohin FËMIJËN.

Nuk është e lehtë të përshkruash përvojën e rritjes së një fëmije me nevoja speciale. Së jashtmi mund të duket stresuese dhe sfiduese, por në zemrën e prindit është një eksperiencë zhvillimi dhe rritjeje personale.

Deri sa ju ka ardhur në jetë një fëmijë me nevoja të veçanta, ti nuk e ke idenë e thellësisë së forcës, këmbënguljes dhe aftësive të tua.

Një nga gjërat më të mira që një komunitet mund të bëjë nuk është të mësojë tolerancën, por ta jetojnë atë, të mos flasë për respektin, por të jetojë gjithëpërfshirjen.

Kur ju mësoni të çmoni fitoret e vogla, nuk keni nevojë për një vijë finishi.

Kënaqu me gjërat e vogla.. Një ditë ju do të ktheheni pas dhe do të kuptoni se ato ishin gjera të mëdha-
Robert Brault

Ne nuk mund të ndryshojmë dot mënyrën se si fëmijët me autizëm shohin botën, por mund të ndryshojmë mënyrën se si bota i sheh këta fëmijë! Autizmi nuk është një zgjedhje.. Pranimi po! Bashkohemi nesër në 2 prill për t'u solidarizuar me prindërit dhe fëmijët e tyre me Autizëm.. Një falënderim special për këngëtarin e mirënjohur Renis Gjoka ,i cili i'u përgjigj me dashamirësi ftesës duke na mbështetur në këtë aktivitet ...

Është e lehtë të flasësh për autizmin por është gjithçka ndryshe të jetosh me të... Do të doja t'u jepja dhimbjen time vetëm për një moment... jo për t'ju lënduar ju, por që ju të më kuptoni se sa e vështirë është për ne të jetojmë në botën tuaj.. E tille është jeta. Autizmi nuk është faji i askujt, ai nuk zgjedh nëse je i bukur apo i shëmtuar, i pasur apo i varfër, drejtues, mjek, apo mësues... Të përpiqemi të ndihmojmë sa më shumë vogëlushë të tillë të aftësohen dhe të integrohen në jetën shoqërore... Nuk mendoj se gjëja më e keqe është të rritësh një fëmijë me autizëm, por të rritësh një fëmijë që përbuz fëmijët tanë me autizëm... sepse Autizmi nuk është faji i askujt. Një komunitet miqësor ndaj autizmit është një komunitet miqësor ndaj të gjithëve ne, prandaj të japim të gjithë kontributin tonë si qytetarë, profesionistë, prindër, të afërm.. të mbështesim fëmijët me autizëm dhe familjet e tyre që të jetojnë me dinjitet jo me mëshirë, të kenë mundësi të zhillojnë potencialet e tyre dhe të kontribuojnë për shoqërinë”.. **Eleni Kotelli- Zv/Kryetare, dega MEDPAK Korçë.**